



KREMTORE



LUTJE TË NDRYSHME



LUTJA NISTORE

DHJAKU: Bekó, o Atë.

PRIFTI: I bekuar është Perendia yne, gjithënjë, taní dhe përherë dhe në jetet e jeteve.

KORI: Amín.

KENDONJESI: Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (*3 here*).

Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, taní dhe përherë dhe në jetet e jeteve, Amín.

Triní e Tereshenjtë, meshirona; o Zot, hirsoji mekatat tona; o Kryezót, fal-i paudhësitë tona; o i Shenjtë, veshetroji, dhe sheroji semundjet tona për emrin tënt.

Meshiró, o Zot (*3 here*).

Ati yne, që je në qell, u-shenjteroftë emri yt; arthte Mbretëria jote; u-befte dëshira jote si në qell edhe mi dhé; buken tonë të përdíçime épnaje neve sot; edhe fálnaji fajet, sikundër edhe né ua falim fajtoreve tanë; edhe mos na shtjer në nga-sje, po shpetona nga i ligu.

PRIFTI: Se jotja është Mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tanë dhe përherë dhe në jetet e jeteve.

KORI: Amin.

SIMBOLI I BESCËS

Besónj me një Perëndí, Atin e tërëfuqishim, krijëtarin e qellit e të dheut e të gjithë të dúkurave dhe të padúkurrave. Dhe me një Zot Jesú Krisht, të vétëmin Bir të Perëndisë, që lindi prej Atit përpara gjithë jeteve. Drite prej Drite, Perëndí të vertete prej Perëndie të vertete, që lindi, dhe nuk u-bë, të bashkëqenshim me Atin, me anën e të cilit u-bënë të gjitha. Që për në njërczit edhe për shpëtimin tonë zbriti prej qellit, edhe u-mishërua prej Shpirtit të Shenjtë edhe Virgjërëshes Marí, dhe u-bë njerí. Që u-kryqësua për në me kohen e Pontit Pillát, edhe vojti, dhe u-varrós, Dhe u-ngjall me të tretën ditë pas Shkrónjave. Dhe u-ngjiti në qell, edhe ndenji me të djathtën e Atit, edhe do të vinjë prapë me lavdí të gjykonjë të gjallët edhe të vdëkurit, edhe Mbretëria e tij do mos ketë mbarím. Dhe me Shpirtin e Shenjtë, Zotin dhe jetëbëresin, që dërgohet prej Atit, që adhurohet, edhe lavderohet me Atin e me Birin, që foli me anën e Profëteve. Me një Kishe të Shenjtë, të përgjithëshme dhe Apostollore. Refénj një Págezim për ndjesën e mekátave. Për ngjalljen e të vdëkurve dhe jetën e botës që vjen. Amin.

LITANIA E MADHE

DHJAKU: Me paqë le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Për paqën që lártazi dhe për shpëtimin e shpërteve tona, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Për paqën e tërë botës, për mirëvajtjen e Kísheve të shenjta të Perëndisë dhe për bashkimin e të gjithëve, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Për këtë Kishe të Shenjtë dhe për atá, që hyjnë këtë me besë, devotese dhe frikë Perëndie, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Për Kryepeshkopin tonë (*aksh*), për priftërinë dhe dhjakerinë e nderuar me Krishtin, për tërë klerin dhe pópullin, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Për Presidentin e Shtëteve të Bashkúara të Amerikës, për ushtërinë dhe aniesinë amerikane, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Që të leiftonjë bashkë me atë, dhe të përmyse nënë kembet e tij çdo armík dhe kundërshtár, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per keté qytét (a Manastír) te shenjtc, per çdo qytét edhe per çdo vent edhe per banoret e tyre me besc, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per butcsinc e éreve, per plotcsinc e pémeve te dheut, edhe per paqcsinc e kóheve, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per lundrezónjesit, per udhetónjesit, per te semuret, per vúajtesit, pér róberit edhe per shpetimin e tyre, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Qe te shpetojme prej çdo hidherimi, merie, reziku dhe nevoje, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Perkraha, shpetona, meshirona dhe rúajna, o Perendí, me hirin tent.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Tereshenjten, te pacinúaren, te permibekúaren, te lavderúaren, Kryezonjen tone, Hyjlíndesen dhe gjithenjé Virgjereshen Marí dyke kujtuar me gjithc Shenjtoret, veten tone dhe njerjatrín dhe tere jeten tone Krishtit Perendí le t'ja pranojme.

KORI: Ty, o Zot.

PRIFTI: Se ty te ka hie çdo lavdí, nder dhe adhurím, Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

LITANIA E VOGËL

DHJAKU: Perserí dhe perserí, me paqe le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Perkraha, shpetona, meshirona dhe rúajna, o Perendí, me hirin tent.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Tereshenjten, te pacinúaren, te permibekúaren, te lavderúaren, Kryezonjen tone, Hyjlíndesen dhe gjithenjé Virgjereshen Marí dyke kujtuar me gjithc Shenjtoret, veten tone dhe njerjatrín dhe tere jeten tone Krishtit Perendí le t'ja pranojme.

KORI: Ty, o Zot.

PRIFTI: Se jotja eshte lartmadhesia, dhe jotja eshte Mbreteria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

Thirrja e Priftit ne Litanine e Vogel ndryshón shpesh, po thirrja e síperme thuhet kurdohere qe s' ka tjater.

LITANIA E GJERG

DHJAKU: Le të thomi të gjithë me tërë shpirtin tonë dhe me tërë mendjen tonë, le të thomi.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

DHJAKU: O Zot i tërëfuqishim, Perendí i Aërterve tanë, të lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshirona, o Perendí, pas meshires sate se madhe, të lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

DHJAKU: Lútemi edhe për Kryepeshkopin tonë (*aksh*), dhe për tërë Vellazerinë tonë me Krishtin.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

DHJAKU: Lútemi edhe për Presidentin e Shtëtëve të Bashkúara të Amerikës edhe për ushterinë dhe aniesinë amerikane.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

DHJAKU: Lútemi edhe për themeltaret e lumur të kësáj Kishe se Shenjtë, për vellézcrit edhe áterit tanë dhe për gjithë të Krishteret besëmire, që prehen ketú dhe kudó.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

DHJAKU: Lútemi edhe për meshiren, jeten, paqen, shendetin, shpëtimin, veshtrimin edhe

ndjesen e mëkátave të shërbëtorëve të Perëndisë (*aksh*).

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

DHJAKU: Lútemi edhe për kujdestaret, famulltaret, përkráhesit, mirebéresit, punetoret edhe këndonjësit e kësáj Kishe se Shenjtë dhe për pópullin, që rri rotull, edhe pret meshiren e pasur dhe të madhe prej teje.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Se ti je Perendí meshireplót edhe njeridashës, dhe ty të dergojmë lavdí, Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, taní dhe përherë dhe në jetët e jéteve.

KORI: Amín.

LITANIA E GJATË

DHJAKU: Le t'ja mbarojmë lutjen tonë Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Për Dhuratat e çemúara të parëvena, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Për këtë Kishe të Shenjtë dhe për atá, që hyjnë ketú me besë, devotese dhe frikë Perëndie, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Që të shpëtojmë prej çdo hidherimi, merie, reziku dhe nevoje, le t'i lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Perkraha, shpetona, meshirona dhe rúajna, o Perendí, me hirin tent.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Diten e tere, te mbare, te shenjte, te paqme dhe te pamekatme, Zotit le t'i lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Engjell páqeje, udheheqes besnik, rúajtes te shpírteve dhe te trúpave tona, Zotit le t'i lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Ndjesë dhe falje te fájeve dhe te mekátave tona, Zotit le t'i lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Te mirat edhe te dobishmet per shpirtet tona dhe paqe per boten, Zotit le t'i lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Qe te shkojme kohen e mbetur te jetes sone me paqe dhe me pendim, Zotit le t'i lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Mbarim te Krishtere, paqesór dhe faqebardhe te jetes sone, dhe mprojtje te mire perpara Gjykatores se trémshime te Krishtit, le t'i lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Tereshenjten, te pacinúaren, te permibekúaren, te lavderúaren, Kryezonjen tone, Hyjlíndesen dhe gjithenjé Virgjereshen, Marí dyke kujtuar me gjithe Shenjtorët, veten tone dhe njerjatrín dhe tere jeten tone Krishtit Perendí le t'ja pranojme.

KORI: Ty, o Zot.

PRIFTI: Me perdellimet e Birit te vetem, me te cilin je i bekuar, bashke me Shpirtin e Tere-shenjte dhe te mire dhe jeteberes, taní dhe perhere dhe ne jetet e jeteve.

KORI: Amín.

PSALMI NISTOR

KENDONJESI: Ejani t'i fálemi dhe t'i pergjúnjemi Krishtit, Perendise dhe Mbretit tone (*3 here*).

PSALMI 104

Bekó Zotin, o shpirti im; o Zot, o Perendia im, je fort i math.

Je veshur me nder edhe madheshtí; je mbuluar me driten si me robe.

E ke shtrire qellin posi kurtine; i ke ndertuar keshtjellat ner újerat.

Ke hipur mi rete si ne qere, dhe fluturón mi fletet e eres.

Frymet jane Engjejt' e tu, flaga dhe zjarri ja-

ne shërbetoret e tu.

E themelove dhene që të mos tundet kurrë.

E ke mbuluar me detin si me robë; i ke përhapur újcrat nëper malet.

I qertove, dhe ikne; u buçite, dhe u-larguan me nxitim.

Hipne nër malet, edhe zbritne nër fushat, në vendin, që u ke caktuar.

U ke vene kufi, që të mos e kapërcejne, dhe të mos derdhen, dhe të mos e mbytin token.

I ke leshuar burimet, që rjedhin tatepjete brí-gjeve nër perrenjte.

Ató u japin uje bagetive të fushes, edhe u shú-ajne etjen úsheve të eger.

Prane tyre banojne shpeshet e qellit, edhe këndojne midís dégeve.

I ke vaditur brigjet me shirat; e ke zbukuruar dhene me pemte e dúarve të tua.

E ke bere barin të mbinje për bagetine; dhe lendinen për shërbimin e njëresve.

Dhe drithen për të ushqyer njerine; dhe veren, që gezón zemren e njeriut.

Dhe vajin, që i ndrit fytyren; dhe buken, që i forcón trupin.

I ke mbjellur, dhe i ke ngritur perpjete druret edhe dellinjat e Libanit, o Zot.

Atjë kanë foletë e tyre shpesh; atjë, në bre-dhat, e ka banesën stërgu.

Atjë, në malet e lartë, ngjiten dhite e égera, dhe lépurat fshihen nëper gurishtat.

Ke bere henen për stinat, edhe ke caktuar pë-rëndimin e diellit.

Leshón erresiren, edhe bëhet natë; edhe dalin, edhe shetitin egersirat e pyllit.

Kelyshet e luáneve ulerijne, dyke kërkuar dhe dyke rrembyer ushqimin e tyre.

Len díelli, ató hiqen mënjane, edhe bien, edhe flene në shtrofkat e tyre.

Njeriu shkon në punen dhe mundimin e vete gjer mbrémane.

Sa të mëdhá janë veprat e tua, o Zot; të gjitha i ke bere me urtesí; dheu është plot me pasurite e tua.

Ja deti i math e i gjerc; atjë ka shërpénj pa numer, shtaza të vógela dhe të mëdhá.

Atjë shkojne lundra; atjë, përbrenda vâlave, lot Leviathani, që ke krijuar.

Të gjitha këto e presin ushqimin prej teje në kohen e duhur; atë, që u jep, e mbledhin.

Ti e hap doren, ató nginjen me të mira; ti e kthen faqen mënjane, ató përzihen.

Ti u merr frymen, ató vdesin, edhe kthehen në pluhurin e tyre.

Ti u dergón frymen, ató ngjallen, edhe faqja e dheut perseritet.

Lavdia e Zotit do të vazhdonje për jete; Zoti do të gezohet për veprat e veta.

Dheu dridhet, kur i shtie syrin; malet leshojne tym, kur i prek me dorë.

Do ta këndónj Zotin sa të rronj, do ta lavderónj

Perendine sa të jem.

Do ta kujtonj Zotin me mall, edhe do të ngazellohem me Zotin.

U-shofshin mekataret nga faqja e dheut, edhe të paudhet mos qofshin më. Bekó Zotin, o shpirti im.

Ke caktuar perendimin e diellit; leshón erresirën, edhe behet natë.

Sa të mëdhá janë veprat e tua, o Zot; të gjitha i ke bërë me urtesí.

Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, taní dhe përherë dhe në jetët e jéteve, Amín. Alilluja, alilluja, alilluja, lavdí me ty, o Perendí (3 here). O Zot, o shpresa jone, lavdí me ty.

PSALMI 51

Meshiromë, o Perendí meshireplót, edhe me shumicën e meshírave të tua shúaji paudhesít' e mia.

Laj-më fare prej paudhesisë sime, edhe qeromë prej mekatit tim.

Se unë i njoh paudhesít' e mia, edhe mekatin tim e kam përpara syve kurdoherë.

Kunder teje vetem fejeva, dhe përpara teje e bera të keqen, që të dalesh i drejtë në fjalët e tua, dhe të jesh i kthjellët në gjyqet e tu.

Se ja tek u-zura në paudhesí, dhe në mekata me lindi nena ime.

Se ja tek deshe të verteten në zemër, edhe mëndjes sime do t'i tregósh urtesí.

Sperkat-më me hysóp, edhe do të qerohem, laj-

më, dhe do të bëhem më i bardhë se debora.

Bej-më të degjónj gezím dhe ngazellím, që të më gezohen eshtrat e thýera.

Ktheje faqen nga mekatat e mia, edhe shúaji gjithë paudhesít' e mia.

Kthjelloma zemrën, o Perendí, edhe perscritma frymën e drejtë.

Mos më hith tej prej faqes sate, edhe mos ma merr frymën tendë të shenjtë.

Epma prapë gezimin e shpëtimit tent, edhe forcome me frymë zoterishtë.

Do tu mesónj fajtóreve udhët e tua, edhe të pabesët do të kthehen më ty.

Shpëtomë prej gjakrash, o Perendí, Perendia i shpëtimit tim, gjuha ime do ta lavderonjë me gezím drejtësinë tendë.

O Zot, çelmi buzët, edhe goja ime do ta leçite lavdinë tendë.

Se të dëshkeshe therorë, do të kisha prurë, po hollokostet nukë të pelqejnë.

Therorë e Perendisë është fryma e thyer; zemrën e thyer dhe të perunjur nukë do ta hedhesh tej, o Perendí.

Bej-i mirë Sionës pas pelqimit tent; edhe ndërtoji muret e Jerusalemit.

Ahere do të pelqësh therorë drejtësie, dhurata dhe hollokoste.

Ahere do të bien dema mi alltarin tent, edhe meshiromë, o Perendí.

PSALMI 103

Bekó Zotin, o shpirti im, i bekuar je, o Zot; bekó Zotin, o shpirti im, edhe ti, o zemra ime, bekó emrin e tij te shenjtc.

Bekó Zotin, o shpirti im, edhe mos i harró mirëberjet e tij.

Aý t'i fal te gjitha paudhesite; aý t'i sherón te gjitha semundjet.

Aý ta çperblén jeten nga prishja; aý te kurorezón me hir edhe meshire.

Aý ta gezón shpirtin me te mira; aý ta perserít djalerine si te shqiponjes.

Zoti gjykón, edhe u jep te drejten gjithc te shtýpurve.

I defteu udhet e veta Moisiut, edhe punet e veta te bijve te Israelit.

Zoti eshte i dhempshur dhe i hirshim, zemergjere dhe meshireplót; nuke zemerohet perhere, as mban merí per jete.

Nuke na perdori pas paudhesive tona, as na çpagój pas mekatave tona.

Se sa lart eshte qelli prej dheut, aqç i math eshte perdellimi i tij per atá, qç i kanë frike.

Sa lark eshte lindja nga perendimi, aqç i largój prej nesh paudhesite tona.

Sikunder i dhembet atit per djemat, ashtú i dhembet edhe Zotit per atá, qç i kanë frike.

Se aý na i di dobesite, dhe mban ment se jemi pluhcr.

Ditet e njeriut jane posi bari, posi lulja e fu-

shes keshtú lulezón.

Se fryn era mi até, dhe shkon, edhe nuke dihet se ku e ka patur vendin.

Po perdellimi i Zotit eshte jete pas jete per atá, qç i kanë frike.

Dhe drejtesia e tij mi bijtc e te bijve dhe mi atá, qç ruajne dhjaten e tij, dhe kujdesen t'i zbatojne porrosite e tij.

Zoti e vendosi fronin ne qell, dhe mbreteria e tij zoterón mi te gjithc.

Bekoni Zotin, ju Engjejt' e tij, te forte per çudi, qç beni porrosite e tij, qç degjoni zerin e fjáleve te tij.

Bekoni Zotin, ju gjithc ushterite e tij, ju meshetaret e tij, qç beni deshiren e tij.

Bekoni Zotin, ju gjithc veprat e tij, ne te gjitha viset e zoterimit te tij; bekó Zotin, o shpirti im.

Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte. Taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve, Amín.

PSALMET E PARÇ

PSALMI 1

Lum aý njerí, qç nuke vete ne keshillen e te paúdheve, qç nuke qendróne ne udhen e mekatáreve, dhe nuke rri ne fronin e madheshtóreve, po ka ne zemer dhe ne mendje ligjen e Zotit nat' e ditc. Aý do te jete si nje lis, i mbjellur anes ujit te lumit, qç siell peme ne stinen e vete, dhe qç nuk i thahet fleta, dhe çdo gjç, qç te benje, do t'i veje

mbare. Po te paudhet jo. Atá do te jenc si kashta, qe e fryn era tutje. Perandáj te paudhet edhe mekataret nuke do te qendrojne dot ne gjykatoren dhe ne mbledhjen e te dréjteve. Sepsé Zoti njeh udhen e te dréjteve, po udha e te paúdheve do te humbase.

PSALMI 2

Persé u-terbuan paganet, edhe persé pópujte mejtojne kotcsira? Mbréterit edhe kreret e dheut u-mblothne, dhe u-keshilluan kunder Zotit e dhe kunder Krishtit te tij, dyke thenc: Le t'i thýejme vargonjte, dhe le t'i hedhim tutje litaret, me te cilat na kane lidhur. Aý, qe rri ne qell, do te qeshc, Zoti do te tallet me atá. Ahere do tu flase i zemeruar, dhe do t'i qertonje i egersuar. E kam vendosur mbretin tim ne bregun e Sioncs se Shenjte. Do ta çpall dekretin, se Zoti me ka thenc: Ti je im Bir, une te kam lindur sot. Lyp-me, dhe do te jap paganet per trashcgím edhe anet mé te larkme te dheut per zotcrím. Do t'i thyesh me shkop te hékurte, do t'i dermósh posi ene tjegullari. Pra, mblídheni mendjen, o mbreter; béhuni te urte, o gjykates te dheut. Sherbéjini Zotit me frike, dhe gezóhuni me perunjési. Pershendósheni Birin qe te mos zemerohet, se posa te ndizet pak, jini te humbur fare. Lum atá qe kane besím me Zotin.

PSALMI 3

O Zot, sa u-shumuan atá, qe me shtrengojne! Shume veta jane ngritur kunder meje. Shume

veta thone qe s'ka shpctím per mua nga Perendia. Po ti, o Zot, je mprojtja ime, lavdia ime dhe mburrja ime. E thirra Zotin me zerin tim, edhe me degjój nga mali i shenjtc. Une rashc, dhe fjeta; u-zgjova, se Zoti me ruan. Nuke do te trembem nga míjera njeresc, qe me sulen perkunder dhe perqárk. Ngrehu, o Zot, shpctome, o Perendia im; se ti i ke goditur te gjithc armiqt e mi ne nofull; ti ua ke thyer dhembet te paúdheve. Zoti eshte shpctimi im, Zoti eshte bekimi i pópullit. Une rashc, dhe fjeta; u-zgjova, se Zoti me ruan.

Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve, Amín. Alluja (*3 here*). Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve, Amín.

PSALMI 4

Degjome kur te therrés, o Perendí i drejtesise; jam ne shtrengice te madhe; kij meshire per mua, dhe degjoma lutjen. O bij te njéresve, gjer kur do ta hithni lavdine time ne balte? Gjer kur do te doni madheshtí dhe grabitje? Mesoni se Zoti e ka shenuar besnikun per veten e tij, se Zoti do me degjonje, kur ta therrés. Rúaju, dhe mos mekató; keshillohu me zemren tende naten, dhe rri urte; blató therore drejtesie, dhe kij besím me Zotin. Shume thone se kush munt te na benje nonje te mire. O Zot, tregoje driten e fytyres sate mi né, se ti na e ke gezuar zemren mé teper se aty-

re, që u shtohet gruri dhe vera. Pra, do të bie, dhe do të fle i qetë; se ti, o Zot me ruan, dhe me shigurón.

PSALMI 5

Ver-u veshin fjalëve të mia, ver-i re mejtimet e mia, o Zot. Dëgjoma klithmen, o Mbreti im dhe Perëndia im, se ty po të lutem. Dëgjoma zerin në mengjës, o Zot, se që me-natë po i ngre sytë për-pjetë, dhe po falem përpara teje. Se ty, o Perëndi, nuk të pelqën ligësia, dhe nuk e durón prapësinë; se nuk i sheh dot me sy të çmendurit, edhe i urrën atá, që vepron padrejtësi; se do t'i çkaterrosh grabitësit, genjesharet edhe gjakataret. Po unë do të vinj në shenjteroren tënde pas meshirës sate, dhe do të falem me frikë përpara tëmpullit tënt. Prirë, o Zot, në drejtësinë tënde nëpër armiqte e mi; drejtësoje udhën përpara meje. Se s'ka besc në gojë të tyre; zemra e tyre është ligësia vetë; gurmazi i tyre është varr i hapur, ndonëse me gjuhën e tyre bëjnë lajka. Çkaterroji o Perëndi; përmbys-i me gjithë pllanët e tyre; hidh-i tutje sipas paudhësive të tyre; se kanë ngritur krye kundër teje. Dhe le të gezohen atá, që të kanë besim; le të brohoritin, se ti i mpron; le të ngazellohen atá, që duan emrin tënt. Se ti, o Zot, do t'i bekosh të drejtët, edhe do t'i pështjellësh me të mira si me mburonjë.

PSALMI 6

O Zot, mos më qertó në zemërimin tënt, edhe mos më mundó në mërinë tënde. Kij meshirë për

mua, o Zot, se jam i pafuqishim; shëromë, o Zot, se më janë thyer eshtrat. Shpirti m'u-trubullua keq; o Zot, gjer kur? Kthehu, o Zot, edhe çliroma shpirtin, edhe shpëtome pas meshirës sate. Se kush do të kujtonjë pas vdekjes, edhe kush do të lavderonjë në varr? Jam lodhur nga psherëtimet, se tërë natën e shkonj me qarje, dhe shtrati im është i mbytur nga lotet. Syri im u-shua prej hidherimit, se më kanë mplakur armiqte e mi. Largóhuni prej meje ju, që vepronin padrejtësi, se Zoti e dëgjój qarjen time; Zoti e priti faljen time. U-turperofshin dhe u-shofshin gjithë armiqte e mi; u-kthefshin prapa me faqe të zeze përnjëherësh.

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, taní dhe përherë dhe në jetet e jeteve, Amin. Alluja, alluja, alluja, lavdi me ty, o Perëndi (3 here). O Zot, o shpresa jonë, lavdi me ty.

GJASHTË PSALMET

PRIFTI: Lavdi Trinisë së Shenjtë, së bashkëqëndshime, jetëbërëse dhe së pandarë, gjithënjë, taní dhe përherë dhe në jetet e jeteve.

KORI: Amin.

KENDONJESI: Lavdi Perëndisë me të lartat, dhe mi dhënë paqe, dhe në njërczit mirëdashje (3 here).

Zot, çelmi buzët, edhe goja ime do ta leçite lavdine tënde (2 here).

PSALMI 3

O Zot, sa u-shumuan atá, që më shtrengojnë!

Shume veta jane ngritur kunder meje. Shume veta thone qe s'ka shpetim per mua nga Perendia. Po ti, o Zot, je mprojtja ime, lavdia ime dhe mburrja ime. E thirra Zotin me zerin tim, edhe me degjój nga mali i shenjtc. Une rashes, dhe fjeta; u-zgjova, se Zoti me ruan. Nuke do te trembem nga mijera njerës, qe me sulen perkunder dhe perqark. Ngrehu, o Zot, shpetome, o Perendia im; se ti i ke goditur te gjithë armiqtë e mi ne noll; ti ua ke thyer dhembet te paudheve. Zoti eshte shpetimi im, Zoti eshte bekimi i popullit. Une rashes, dhe fjeta; u-zgjova, se Zoti me ruan.

PSALMI 38

O Zot, mos me qertó ne zemërimin tent, edhe mos me mundó ne merine tende. Se shigjetat e tua me çpojne thelle, dhe dora jote me shtrengón rende. S'kam shendét ne trupin nga shkaku i zemërimit tent, edhe s'kam qetesí ner eshtrat nga shkaku i mekátave te mia. Se paudhesite me kane hipur mi koke, dhe me shtypin si një barrë e rende. Se jam plagosur dhe jam kalbur nga marrësitë e mia. Jam bere i ngrate, dhe jam krusur fare; tere ditën ecnj i vreret. Se me jane ndezur mushkerite, dhe me eshte venituri trupi. U-semura, dhe u-keputa fare; ulerinj nga shtrengimi i zemres sime. O Zot, ti ma sheh nevojen, ti ma degjón psheretimen. Zemra m'u-perzie, forca me neveriti, edhe drita e syrit m'u-err. Miqtë dhe te áfermit e mi u-larguan prej meje, dhe gjirinjte

me kane neveritur. Dhe atá, qe duan te me marrin shpirtin, me ngrehin kurth, edhe atá, qe me duan te keqen, perhapin çpifje dhe genjeshtra kunder meje tere ditën. Po une, posi i shurdher, nukë degjónj; dhe posi neméc, nukë flas; dhe u-bera sikur s'kam as veshe as gojë. Po kam shprese me ty, o Zot; se ti do te me degjósh, o Zot, o Perendia im, dhe nukë do t'i lesh te paudhet te gezohen, dhe te mburren kur te permbysem. Se jam gatí per te rënë, dhe ti po ma sheh hidherimin. Se do t' i çpall paudhesite e mia, dhe do te pendohem per mekátat e mia. Po armiqtë e mi jane te shendoshe dhe te forte, edhe jane shumuar atá, qe me urrejne padrejtesisht. Edhe atá, qe kthejne te keqen per te miren, jane kundërshtaret e mi, se une ndjek te miren. Mos me neverit, o Zot; mos u-largó prej meje, o Perendia im. Eja shpejt, edhe ndih-me, o Zoti i shpetimit tim.

PSALMI 63

O Perendí, ti je Perendia im; qe ne mengjës po te kerkónj; shpirti im ka etje per ty, si ne dhé te shkrete dhe te thate, ku s'ka uje. Se dua ta shoh fuqine tende dhe lavdine tende, sikunder te pashes ne shenjteroren. Se perdellimi yt eshte mé i mire se jeta, dhe buzet e mia do te lavderojne. Keshtú do te bekónj sa jam i gjalle, dhe do t'i ngre dúarte per emrin tent. Shpirti im do te ngjnjët posi prej te majmi dhe prej dhjami, dhe goja ime do te lavderonje me buze te qeshur. Do te kujtónj nat' e dite, se ti ke qene ndihmesa im, pe-

randáj do te gezohem nene hien e fléteve te tua. Shpirti im u-ngjit pas teje, se ti me permbán me doren e djathte. Po atá, qe duan te me marrin shpirtin, do te perpihen prej gremines, do te theren prej shpates, do te copetohen prej çakajve. Dhe mbreti do te gezohet me Perendine; cilidó, qe betohet per até, do te lavderohet; dhe do tu thuret goja atyre, qe flasin genjeshtra. Do te kujtónj nat' e dite, se ti ke qene ndihmesi im, perandáj do te gezohem nene hien e fléteve te tua. Shpirti im u-ngjit pas teje, se ti me permbán me doren e djathte.

Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve, Amín. Alluja (*3 here*). Meshiró, o Zot (*3 here*). Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

PSALMI 88

O Zot, o Perendí i shpertime tim, dit' e nate po te therrés; le te vinje lutja ime perpara teje; ver-i veshin klithmes sime. Se shpirti im u-mbush me trubullime, dhe jeta ime po afrohet ne varr. U-numerova me atá, qe zbresin ne grope; u-bera posi njeri pa jete; jam hedhur ne te vdékurit edhe te vraret, te cilet i ke harruar, dhe i ke neveritur. Me shtive ne gropen mé te poshtme, mé te erret edhe mé te thelle. Zemerimi yt krisi mi mua, dhe valat e tua po me rahin. Mergove prej meje te njóhurit e mi; me bere te mallkuar per

atá; u-mbylla, dhe s'munt te dal jashte. Syri im u-err prej hidherimit; thirra me ty, o Zot, tere ditën; dhe i ndeva dúarte perpara teje. Mos do te besh çudira per te vdékurit, apó te vdékurit do te ngrihen, dhe do te lavderojne? Mos do te çpallet meshira jote ne varr, dhe madheshtia jote ne greminë? Mos do te çfaqen merékullat e tua ne erresire, dhe drejtësia jote ne shkretetire? Po une thirra me ty, o Zot, edhe qe ne mengjés lutja ime do te arrije perpara teje. Persé e heth tutje shpirtin tim, o Zot, persé e kthen menjane faqen tende prej meje? Jam i keputur dhe i munduar per vdekje qe prej djalerise; po vuanj, dhe po vras mendjen nga frika jote; jam i tronditur dhe i drithteruar nga tmerrri i zemerimeve te tua. Me qerthulluan posi uje, me qarkuan reth e rotull tere ditën. Mergove prej meje mikun dhe te áfermin dhe te njóhurit e mi ne erresire. O Zot, o Perendí i shpetime tim, dit' e nate po te therrés; le te vinje lutja ime perpara teje; ver-i veshin klithmes sime.

PSALMI 103

Bekó Zotin, o shpirti im, edhe ti, o zemra ime, bekó emrin e tij te shenjte. Bekó Zotin, o shpirti im, edhe mos i harró mireberjet e tij. Áy t'i fal te gjitha paudhesite; áy t'i sherón te gjitha semundjet. Áy ta çperblén jeten nga prishja; áy te kurorezón me hir edhe meshire. Áy ta gezón shpirtin me te mira; áy ta perserít djalcerine si te

shqiponjes. Zoti gjykón, dhe u jep te drejte gjithë te shtëpurve. I defteu udhet e veta Moisiut, edhe punet e veta te bijve te Israelit. Zoti esht i dhempshur dhe i hirshim, zemergjere dhe meshireplót; nuke zemerohet perhere, as mban meri per jete. Nuke na perdori pas paudhesive tona, as na çpagój pas mekátave tona. Se sa lart eshte qelli prej dheut, aqë i math eshte perdellimi i tij per atá, qe i kane frike. Sa lark eshte lindja nga perendimi, aqë i largój prej nesh paudhesite tona. Sikunder i dhembet atit per djemat, ashtú i dhembet Zotit per atá, qe i kane frike. Se ay na i di dobesite, dhe mban ment se jemi plucher. Ditet e njeriut jane posi bari, posi lulja e fushes keshtú lulezón. Se fryn era mi até, dhe shkon, edhe nuke dihet se ku e ka patur vendin. Po perdellimi i Zotit eshte jete pas jete mi atá, qe i kane frike, dhe drejtesia e tij mi bijte e te bijve dhe mi atá, qe rúajne dhjaten e tij, dhe kujdesen t'i zbatojne porrosite e tij. Zoti e vendosi fronin ne qell, dhe mbreteria e tij zoterón mi te gjithë. Bekoni Zotin, ju Engjejt' e tij, te forte per çudí, qe beni porrosite e tij, qe degjoni zerín e fjáleve te tij ju meshetaret e tij, qe beni deshirat e tij. Bekoni Zotin, ju gjithë veprat e tij, ne te gjitha viset e zoterimit te tij. Bekó Zotin, o shpirti im.

PSALMI 143

O Zot, degjoma faljen, ver-u veshin lútjeve te mia. Pergjeqmu pas miresise dhe pas drejtesise

sate, dhe mos hyr ne gjyq me sherbetorin tent, se asnjé njeri i gjalle nuke munt te dale i drejte perpara teje. Se armiku ma ndoqi shpirtin; ma shtypi jeten perdhé; me varrosi ne erresire si te vdekur prej kohe. Perandáj me eshte keputur shpirti, dhe me eshte deshperuar zemra. Kujtónj ditet e lashta, mejtónj gjithë veprat e tua. I ndeh dúarte perpara teje, shpirti im ka etje per ty posi dheu i thate. Pergjeqmu shpejt, o Zot, se m'uzu fryma, mos e kthe menjane faqen tende prej meje, se jam bere si atá, qe hidhen ne grope. Bej-me te shoh meshiren tende ne mengjés, se me ty kam shprese, bej-me te njoh udhen, ku duhet te ecenj, se me ty e kam varrur shpirtin. Çlirome prej armiqve te mi, o Zot, se prane teje vinj te fshihem; mesome te benj deshiren tende, se ti je Perendia im; tregoma udhen e drejtesise, se ti je zemermire. Ngjall-me, o Zot, per emrin tent; edhe pas drejtesise sate nxirma shpirtin nga trubullimet; edhe pas meshires sate shtyp-i armiqte e mi, dhe shúaji gjith atá, qe ma mundojne shpirtin, se une jam sherbetori yt. Degjome, o Zot, pas drejtesise sate, edhe mos hyr ne gjyq me sherbetorin tent; tregoma udhen e drejtesise, se ti je zemermire.

Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín. Alilluja, alilluja, alilluja, lavdí me ty, o Perendí (*3 here*). O Zot, o shpresa jone, lavdí me ty.

THIRRTORET

Ty, o Zot, te thirra ne mengjés; degjoma lutjen, degjoma lutjen, shpejt o Zot. Ty o Zot, te thirra ne mengjés; degjoma lutjen, ver-i veshin zerit te lutjes sime. Ja ku te therrés qe ne mengjés; degjoma lutjen, shpejt o Zot.

Le te drejtohet posi temjani, lutja ime sot, perpara teje; duart' i ngre perpjete, per mbreme si per kurbán; degjoma lutjen, shpejt o Zot.

VARGJET E THIRRTOREVE

Çliroma shpirtin prej burgut, qe ta lavderónj emrin tent.

Te drejtet do me rrethojne, se do me bekósh me te mira.

Prej thelesírave thirra me ty, o Zot; o Zot, degjoma zerin.

Ver-i veshin zerit te lutjes sime.

Po t'i vesh re paudhesite, kush munt te qendronje perpara teje, o Zot? Po prane teje eshte ndjesa.

Jam dyke pritur Zotin, dhe shpirti im ka shprese ne fjalën e tij.

Qe ne mengjés gjer mbrémame le te shperenje Israeli me Zotin.

Se Zoti ka meshire, dhe aý do ta çperblenje Israelin nga te gjitha paudhesite.

Lavderójeni Zotin, gjithë kombet; lavderójeni, gjithë pópujte.

BEKIMORET

I bekuar je, o Zot, mesome te drejtat e tua.

Gjithë Engjejt' e qellit, u-çuditne kur pane, qe u-shtrive i vdekur, dhe dermove Shpetimtár, tiranín' e Sketerres, dhe me veten tok, ngjalle gjithë njérezit, dhe çlirove gjithë te burgósurit.

I bekuar je, o Zot, mesome te drejtat e tua.

Ç' e sperkatni me myrra, ç' e vajtoni me lote, gra besnike mi varrin? I pyeste me çudí, driteprúresi Engjell, dhe u thosh keshtú, grave myrreprúrese: Shihni vete, Krishti u-ngjall se vdékuresh.

I bekuar je, o Zot, mesome te drejtat e tua.

Qe me-nate shpejtuan, Myrreprúreset rentne, dhe mi varrin vajtonin, po nje Engjell i qendrój, i shkelqyer me drite, dhe u thosh keshtú: Zia shkoj mos qani mé. Apostujve lajmen gazmore shpjéruni.

I bekuar je, o Zot, mesome te drejtat e tua.

Myrreprúreset arthne, qe me-nate me myrra, dhe mi varrin vajtonin, po qendruan me çudí, kur u thirri nje Engjell: Si e nemeroni te gjallin me te vdékurit? Se aý u-ngrit prej varrit si Perendí.

LAVDI. Po i fálemi Atit, edhe Birit te vetem, edhe Shpirtit te Shenjte, qe perbejne Trinine, me substancën e njeshme, dhe me brohorí therresim si Engjejtë: Shenjt i Shenjtóreve i Shenjte je.

TANI. Jetcbéresin linde, Virgjereshe dhe Nene, e çlirove Adamin, i dhurove gazin Eves, te helmuar prej jete; ishin nene dhé, po i shpuri lart ne qell, Jesú Krishti, Biri yt njeri dhe Perendí.

Alilluja, alilluja, alilluja, lavdí me ty o Zot
(3 here).

PASSI PAMË NGJALLJEN

Passi pame Ngjalljen e Krishtit, le t'i fálezmi Zotit të Shenjte Jesús, të vétëmit të pamekatme. Adhurojmë Kryqin tënt, o Krisht, edhe hymnojmë dhe lavderojmë Ngjalljen tënde të Shenjte, se ti je Perendia ynë, veç teje nukë njohim tjetër Perendí, dhe emrin tënt po e emcrojmë. Ejani të gjithë, o besnikë, ta adhurojmë Ngjalljen e Shenjte të Krishtit, se ja me anën e Kryqit ka ardhur gezím në tërë botën, se dyke duruar kryqin, e dermove vdekjen me vdekje.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalerisë, shumë pasione më leftojnë, po ti perkrahe-më dhe shpetomë, o Shpetimtari im.

Ju që urreni Sionën, do të turpëroheni prej Zotit, dhe do të fishkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjte, merr je të çdo shpirt, dhe lartësohet në paqësi, dhe ndriçohet prej njësisë Trinisore mistikërisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tërë krijesën për jetelindje.

MADHËSHTIMET

Madhështoje Zotin, o shpirti im, edhe ti, o mendja ime, ngazellohu më Perendinë Shpetimtarin tim.

Ti je e nderuar më Kerubím, dhe e lavderuar pa përqsje më Serafím; ti më të vertetë lindë Fjalë

Perendinë. Pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyjlindëse.

Se e hodhi syrin më perunjesin' e sherbetores se vetë, se ja që-tani e tutje gjithë brezat do më lumërojnë.

Ti je e nderuar më Kerubím, dhe e lavderuar pa përqsje më Serafím; ti më të vertetë lindë Fjalë Perendinë. Pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyjlindëse.

Se më madhështoj më fuqishmë, dhe emri i tij është i shenjtë; dhe perdellimi i tij do të jetë bres pas brezi më atá, që i kanë frikë.

Ti je e nderuar më Kerubím, dhe e lavderuar pa përqsje më Serafím; ti më të vertetë lindë Fjalë Perendinë. Pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyjlindëse.

Refeu forcë më krahu e vetë; i perndau kryelartët nga mejtimi i zëmërave të tyre.

Ti je e nderuar më Kerubím, dhe e lavderuar pa përqsje më Serafím; ti më të vertetë lindë Fjalë Perendinë. Pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyjlindëse.

I përmbysi të fuqishmet prej frónëve, dhe i lartësoj të perunjurit; të urretit i mbushi më të mira, dhe të pásurit i dboj të zbrazet.

Ti je e nderuar më Kerubím, dhe e lavderuar pa përqsje më Serafím; ti më të vertetë lindë Fjalë Perendinë. Pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyjlindëse.

E perkrahu të birin Israél pas meshires se vetë, siç u ishte zotuar Aterve tane, Abrahamit dhe fares se tij për jetë.

Ti je e nderuar më Kerubím, dhe e lavderuar pa

perqasje mi Serafím; ti me të vertetë linde Fjalë Perendine. Pra ty të madheshtojme, Zonje Hyjlindese.

LAVDERIMET

Çdo frymë le ta lavderonjë Zotin; lavderójeni Zotin prej qellit, lavderójeni në më të lartat. Ty të ka hie kënga, o Perendí.

Lavderójeni gjithë Gngjajt' e tij; lavderójeni gjithë forcat e tij. Ty të ka hie kënga, o Perendí.

VARGJET E LAVDERIMEVE

Kjo lavdí do të jetë mi gjithë Shenjtoret e tij.

Lavderójeni Perendinë me Shenjtoret e tij; lavderójeni për shigurinë e fuqisë së tij.

Lavderójeni për poterat e tij; lavderójeni për shkelqimin e madhërisë së tij.

Lavderójeni me trumbetë; lavderójeni me këngëtores dhe me gitare.

Lavderójeni me timpane dhe me valle; lavderójeni me kordha e me strumenta.

Lavderójeni me kimbale tingellónjëse; lavderójeni me kimbale brohoritese; çdo frymë le ta lavderonjë Zotin.

Ngrehu, o Zot, o Perendia im; le të lartësohet dora jote; mos i harró të vërferit e tu në funt.

Do të refénj, o Zot, me gjithë zemrën time; do t'i leçit të gjitha çudirat e tua.

DOKSOLLOGJIA E MADHE

Lavdí ty, që na refëve driten, lavdí Perendisë

me të lartat, dhe mi dhënë paqe, dhe në njërczit miredashje.

Të hymnojmë, të bekojmë, të falemë, të lavderojmë, ty të perhirojmë për lavdinë tënde të madhe.

Zot Mbret, Perendí qellor, At i tërëfuqishim, Zot Bir i vetëm Jesú Krisht, edhe Shpirti Shenjt.

Zot Perendí, qengji i Perendisë, i Bir i Atit, që ngre mekatin e botes; meshirona, ti që ngre mekatin e botes.

Prit faljen tonë, ti që rri me të djathten e Atit, edhe meshirona.

Se ti je Shenjt i vetëm, ti je Zot i vetëm, Jesú Krishti, për lavdí të Perendisë Atit, Amin.

Për ditë do të bekónj, dhe do ta lavderónj emrin tënt për jetë dhe më jetet e jetes.

Vlerësona, o Zot, këtë ditë të rúhemi pa nonjë mekát.

I bekuar je, o Zot, Perendí i Aterve tanë, dhe emri yt është i kënduar dhe i lavdëruar për jetë, Amín.

Le të jetë, o Zot, perdellimi yt mi në, sikunder kemi shpresuar mi ty.

I bekuar je, o Zot, mesomë të drejtat e tua (*3 here*).

O Zot, ke qenë perikja jonë bres pas brezi. Une thashë: O Zot, meshiromë; sheroje shpirtin tim, se fejeva me ty.

O Zot, me ty perika; mesomë të benj dëshirën tënde, se ti je Perendia im.

Se ti je burimi i jetës, me driten tende do të shohim drite.

Zgjat-e perdellimin tent mi atá, që të njohin.

Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (*3 here*).

Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjte.

Taní dhe perhere dhe në jetet e jéteve, Amín.
Shenjt i pavdekur, meshirona.

Shenjt Perendí.

Shenjt i fuqishim.

Shenjt i pavdekur.

Meshirona.

LUMGRIMET

Në Mbretërinë tende kujtona, o Zot, kur të vish në Mbretërinë tende.

Lum të vërferit nga mendja, se e atyre është Mbretëria e qellit.

Lum atá, që vajtojne, se atá do të ngushe-llohen.

Lum të butet, se atá do ta trashëgojnë dhënë.

Lum atá, që kanë urí dhe etje për drejtësi, se atá do të nginjen.

Lum zemerdhëmpshurit, se atá do të meshirohen.

Lum të paqmet nga zemra, se atá do ta shohin Perëndinë.

Lum paqebéresit, se atá do të quhen bij të Perëndisë.

Lum atá, që ndiqen për drejtësi, se e atyre është Mbretëria e qellit.

Lum ju, kur ju shajnë, dhe ju ndjekin, dhe thonë çdo fjale të keqe kundër jush dhe genjeshtra kundër meje.

Gezohuni dhe ngazellohuni, se roga juaj do të jetë e madhe në qell.

Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjte.

Taní dhe perhere dhe në jetet e jéteve, Amín.

PERLËSHIMI I SHKURTER

PRIFTI: Lavdí më ty, o Perëndia yne, lavdí më ty.

KORI: Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjte, taní dhe perhere, dhe në jetet e jéteve, Amín. Meshiró, o Zot (*3 here*). Bekó, o Ate.

PRIFTI: Krishti Perëndia yne i vertetë, me nermjetimet e Shen Marisë dhe të gjithë Shenjtóreve, na mëshirofte, dhe na shpëtofte si i mirë dhe njeridashës.

KORI: Amín.